



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

Nr. 337 Prot

Tiranë, më 17/4 /2015

URDHËR

Nr. 86, datë 17/4/2015

“Për tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar ”

Mbështetur në nenin 13 , të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ :

1. Tarifa e shërbimit të dhënies së informacionit (fotokopje ose CD) të jenë si më poshtë :

- Deri në 10 fletë informacioni përfitohet pa pagesë.
- Mbi 10 fletë , për formatin A4 , pagesa do të jetë 5 (pesë) lekë /fletë.
- Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 (gjashtëdhjetë) lekë /CD.

2. Specialisti përkatës i sektorit , i cili do të përgatisë informacionin e kërkuar , në bashkëpunim me koordinatorin për të drejtën e informimit të institucionit, duhet të përlogarisë koston totale të informacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuarit/subjektit të interesuar.

3. Me pagesën e tarifës përkatëse nga kërkuari/subjekti i interesuar, sipas faturës së arkëtimit (të miratuar), në llogarinë e institucionit dhe paraqitjen e mandatit bankar, menjëherë i dërgohet kërkuarit/subjektit të interesuar informacioni (me postë) ose mund ta tërheqë atë dorazi.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit , pranë KDIMDP-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

